VENDIM
Nr. 193, datë 9.3.2016

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 138, DATË 31.3.1994, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KOMPENSIMIN E SHPENZIMEVE NGA NDRYSHIMI I ÇMIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHE LËNDËVE DJEGËSE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 54, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 138, datë 31.3.1994, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Shkronja "b", e pikës 2, të kapitullit I, shfuqizohet;
2. Shkronja "c", e pikës 3, të kapitullit II, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi